



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

---

Nr.1120/2 Prot.

Tiranë, më 30.12.2016

**V E N D I M**

**Nr.171, Datë30.12.2016**

**PËR**

**EVADIMIN E MATERIALEVE MBI SHQYRTIMIN E CILËSISË SË  
DOSJEVE TË AUDITIMIT NË “TË FTOHTË”  
PËR 9 MUJORIN 2016.**

Pasi u njoha me Raportin dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i shqyrtimit të cilësisë së dosjeve të auditimit “në të ftohtë” të Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikes, shpjegimet e dhëna nga grupet e auditimit dosjet e të cilëve u përzgjodhën për shqyrtimin e cilësisë, në mbështetje të nenit 25 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI, ISSAI 40, ISSAI 5600, Regullores së Brendshme mbi organizmin dhe Funksionimin e KLSH-së dhe Urdhrit nr.137, datë 5.11.2016 të Kryetarit të KLSH-së,

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin “Mbi gjetjet dhe konkluzionet e kontrollit për sigurimin e cilësisë në “të ftohtë”, ushtruar në zbatim të urdhrit të Kryetarit nr. 137 datë 05.11.2016 “Për kontrollin e sigurimit të cilësisë” .

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara për sa vijon:

## **1.Gjetje:**

Nisur nga rezultati i vlerësimeve të dhëna për çdo kriter mbi dosjet e përzgjedhura për kontrollin e cilësisë, i cili u krye bazuar në Ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Rregulloren nr. 85, datë 30.06.2015 mbi “Organizimin dhe funksionimin Administrativ të KLSH-së”, Formularët Standardë të Auditimit (pjesë përbërëse e Rregullos nr. 53, datë 16.04.2012 “Për Organizimin dhe Funksionimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit” e shfuqizuar pasi Formularët Standardë të Auditimit në zbatim të Rregullos nr. 85, datë 30.06.2015 nuk janë miratuar, për atë kohë sa ato nuk bien ndesh me këtë rregullore ato janë të zbatueshme), Standardet e auditimit të INTOSAI-t, praktikat më të mira, tre tipe formularësh vlerësimi referuar llojit të auditimit (ligjshmëri-rregullshmëri/përputhshmëri, financiar dhe performance),

### **Për sa sipër rekomandojmë:**

*Në zbatim të Rregullos së Brendshme mbi “Organizimin dhe funksionimin Administrativ të KLSH-së”, miratuar me Vendimin nr. 85, datë 30.06.2015 të Kryetarit, të hartohen dhe miratohen Formularët Standardë të Auditimit.*

**Menjëherë**

### **I-Për Fazën e planifikimit të auditimit**

#### **1.Gjetje:**

Fenomeni që vihet re në këtë aspekt, është se nuk ekziston ndonjë dokumentacion ose short-informacion, mbi përzgjedhjen e subjektit dhe arsyet e planifikimit. Ky koment është për vlerësimin e dosjeve të subjektit Bashkia Belsh, Bulqizë, Maliq, Rrogozhinë ndërsa për subjektet e tjera është marrë i mirëqenë fakti se plani vjetor i auditimeve bëhet mbi bazë studim risku dhe materialiteti, dhe informacioni mbi përzgjedhjen e subjektit dhe planifikimin e tij për auditim, është pjesë përbërëse e planit vjetor të auditimeve.

#### **Për sa sipër rekomandojmë:**

*Hartimi i programit të auditimit të shoqërohet me short-listën e informacionit paraprak për subjektin ku, të jenë indentifikuar zonat e riskut, në mënyrë që programit ti shërbejë qëllimit të auditimit, të përfundojë në afatin e caktuar dhe me grupin e audituesve të përzgjedhur, i cili çon në një vlerësim me siguri të cilësisë dhe jap garanci.*

**Menjëherë**

#### **2.Gjetje:**

Në shumicën e rasteve përzgjedhja e numrit të audituesve ka qenë e mjaftueshme dhe ndarja e detyrave sipas drejtimeve të programit të auditimit është bërë konform Formularëve Standardë të Auditimit.Pavarësisht këtij fakti konstatohen dhe raste, kur për shkak të mos përzgjedhjes mjaftueshëm të numrit të audituesve, kemi patur ndryshim programi dhe për pasojë është kërkuar shtese në grupin e auditimit. Ky fenomen konstatohet në dosjet e subjektit Bashkia Bulqizë dhe Bashkia Maliq, Drejtoria Rajonale Mjedisore, Qarku Tiranë, apo në dosjen e subjektit Enti Kombëtar i Banesave.

### **Për sa sipër rekomandojmë:**

*Nga drejtuesit e departamenteve, në krijimin e grupeve të auditimit të mbahet parasysh short-lista e informacionit paraprak për subjektin në mënyrë që të ketë një zgjedhje racionale të grupit të auditimit, aftësisve të kërkuara për auditim dhe afatit për përfundimin e auditimit.*

*Menjëherë*

### **3.Gjetje:**

Në të gjitha dosjet e përzgjedhura konstatohet se, ekziston formulari “njoftim për fillim auditimi”, sipas Formularëve Standardë të Auditimit (Dokumenti nr. 2) por në shumicën e dosjeve nuk ka fizikisht dokumente të cilat të evidentojnë mbledhjen e informacioneve paraprake për subjektin nën auditim, sipas pikës (A) “Njohja me subjektin” të Dokumentit nr. 1 “Letrat e punës”, si dhe referuar ISSAI 4100, informacioni mbi subjektin, i listuar në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë. Mungesa e këtij dokumentacioni është konstatuar për dosjet e subjekteve Bashkia Maliq, Bulqizë, Belsh, ZVRPP Gjirokastrë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Durrës, Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, etj.

### ***Për sa sipër rekomandojmë:***

*Në hartimin e Formularëve Standardë të Auditimit të rishikohet Dokumenti nr. 1, Formularët Standardë të Auditimit të Ligjshmërisë, duke reduktuar letrat e punës në një short informacion, ku të listohet i gjithë dokumentacioni i marrë nga grupi i auditimit si informacion paraprak nga subjekti, i cili përbën të dhënat e këtij informacioni.*

*Menjëherë*

## **II-Për Fazën e Raportimit dhe Evadimit të materialeve të auditimit**

### **1. Gjetje**

Për vlerësimin e këtij kriteri, grupi ka dhënë disa komente të cilat konsistojnë në probleme të ndryshme, megjithatë ky fakt lidhet me përgatitjen profesionale të audituesve në veçanti dhe grupit në përgjithësi. Kjo ka bërë që pavarësisht vlerësimit për këtë kriter të mos jepet siguri e mjaftueshme për cilësinë pasi shihet në këndvështrime të ndryshme. Ndodhur në këto kushte më poshtë jepen shembuj për disa nga këto rastet. Në dosjen e subjektit FSHZH, UKT, pasqyrimi në raport i konstatimeve të grupit të auditimit është bërë me një gjuhë të thjeshtë, por të zgjatur duke sjellë në fokus fakte të panevojshme, të cilat nuk ndikojnë në konstatimin apo përshkrimin e konstatimit. Për pasojë, raporti në disa pjesë të tij bëhet i lodhshëm dhe konkretisht në trajtimin e prokurimeve publike. Për pasojë Raporti nuk është në përputhje me Dokumentin nr. 11, Formularët Standardë të Auditimit të ligjshmërisë, kap.IV. Në dosjen e subjektit Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe ZVRPP Berat, konstatohet se Raporti përmban tabela të dhënash të konsiderueshme, për të cilat nuk është vendosur në asnjë rast burimi i të dhënave. Gjithsesi gjuha e përdorur është e thjeshtë por duke qenë e lidhur edhe me çështje teknike dhe specifike, në disa raste zgjatet dhe komplikohet. Përgjithësisht, raporti paraqitet në një formë dhe gjuhë korrekte.

***Për sa sipër rekomandojmë:***

*Nga grupet e auditimit të merren masa që trajtimi i konstatimeve në Projektraport/Raport Auditimi, të jetë i strukturuar konform Dokumenteve Standardë të Auditimit dhe mos të ketë përsëritje të fenomeneve, gjë e cila rëndon përmbajtjen e Projektraportit/Raportit të Auditimit.*

*Menjëherë*

**2. Gjetje**

Evidencat e rezultateve të auditimit janë të mbajtura sipas afateve, formës dhe përmbajtjes të parashikuara në Rregulloren e Brendshme dhe formularëve standard të miratuar por ato kanë shumë rubrika që rëndojnë statistikën dhe nuk janë tregues të rezultateve të kërkuara të auditimit.

***Për sa sipër rekomandojmë:***

*Në hartimin e Formularëve Standardë të Auditimit, të rishikohen Evidencat e Auditimit, pasi kanë shumë rubrika të cilat rëndojnë statistikën dhe nuk janë tregues të rezultateve të kërkuara të auditimit.*

*Menjëherë*

**3. Gjetje**

Në disa dosje mungonte Dokumenti nr. 17, “Vlerësimi i cilësisë së kontrollit” ose në disa raste figuron jo konform standardit si në dosjen e UKT, FSHZH, ZVRPP Berat, Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj.

***Për sa sipër rekomandojmë:***

*Nga Drejtorët e Departamenteve dhe nga kryeaudituesit të marren masa për plotësimin të gjithë dokumenteve të kërkuar dhe në veçanti Dokumentit nr. 17, “Vlerësimi i cilësisë së kontrollit”.*

*Menjëherë*

**4. Gjetje**

Në disa raste rezultoi se dosjet e auditimit janë dorëzuar me vonesë pranë zyrës së arkivit, si dhe dosjet “Fondi i sigurimit të detyruar të kujdesit shëndetësor”, “Shërbimi Informativ Shtetëror”, “Këshilli i Qarkut Durrës”, “Enti Kombëtar i Banesave”, “Drejtoria Rajonale e Mjedisit Tiranë” dhe “Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve” nuk kanë qenë të arkivuara deri në momentin e nisjes së shqyrtimit të kontrollit të cilësisë.

***Për sa sipër rekomandojmë:***

*Përgjegjësit e Grupeve të auditimit të marrin masa për të dorëzuar në kohë pranë zyrës së arkivit dosjet e përfunduara të auditimit, në përputhje me Urdhrin nr. 59 datë 30.04.2015 i Kryetarit të KLSH i ndryshuar.*

*Menjëherë*

## **5. Gjetje**

Në disa raste nuk ka gjurmë në dosje, kur nga subjekti nuk është parë e arsyeshme që të realizohet takimi mbyllës pas përfundimit të auditimit dhe dërgimit në subjekt të Projektraportit.

### ***Për sa sipër rekomandojmë:***

*Të lihet gjurmë në dosjet e auditimit, në rastin kur nga subjekti nuk është parë e arsyeshme për tu realizuar takimi mbyllës para se të përgatitet Raporti Përfundimtar i Auditimit.*

*Menjëherë*

## **6. Gjetje**

Në përgjithësi nuk ka ndryshime të pajustificuara mes Projektraportit të Auditimit dhe Raportit Përfundimtar në dosjet e përzgjedhura për vlerësim. Konstatohet se ka mangësi të natyrave të ndryshme në lidhje me këtë kriter. Në dosjen e subjektit Bashkia Bulqizë, rekomandimet “Masa organizative” dhe “Masa shpërblim dëmi” të paraqitura në Projektraport nuk janë të gjitha edhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Nga 27 “Masa organizative” paraqitur në Projektraport, në Raportin përfundimtar të auditimit rezultojnë 16 masa. Këto ndryshime janë bërë si rezultat i riformulimit të masave dhe argumenteve ligjore gjatë fazës së vlerësimit nga hallkat vlerësuese të cilësisë, por në disa raste në Raport nuk janë evidentuar ndryshimet dhe argumentet mbi të cilat janë kryer ndryshimet. Në dosjen e subjektit Bashkia Maliq, rezulton se nga 14 “Masa organizative” trajtuar në Projekt raport, në Raport Përfundimtar të auditimit rezultojnë 15 masa të tilla. Ndryshimet kanë ardhur si pasojë e riformulimit të masave dhe argumenteve ligjore gjatë fazës së vlerësimit të observacioneve, të cilat nuk ishin trajtuar në fazën e Projekt raportit, si dhe të pasqyrimin të vërejtjeve të bëra nga Kryetari i KLSH-së.

### ***Për sa sipër rekomandojmë:***

*Të bëhen pjesë e dosjes së auditimit dhe vërejtjet apo ndryshimet në lidhje me rekomandimet e kërkuara në Projektvendim, në mënyrë që të identifikohen ndryshimet që mund të rrjedhin nga rekomandimet e pasqyruara në Projektraport/projektvendim në ato të pasqyruara në Raportin Përfundimtar/ Vendimin përfundimtar.*

*Menjëherë*

## **7. Gjetje**

Nga 30 dosjet e shqyrtuar për sigurimin e kontrollit të cilësisë, dosja e auditimit në subjektin Enti Kombëtar i Banesave është auditim pilot bazuar në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë dokumentet e përfshira në dosje nuk janë në përputhje me specifikat e trajtuara në manualin përkatës.

### ***Për sa sipër rekomandojmë:***

*-Të rishikohen rubrikat e Fazës së Planifikimit, ku të dokumentohet vlerësimi i materialitetit dhe i riskut. Të bëhet ndarja e saktë e Projektit të Planifikimit të Auditimit dhe të Programit të Auditimit, duke u hartuar formati standard i tyre. Në fazën e kryerjes së auditimit në terren të hartohen procedurat standarde sipas mënyrës dhe përmbajtjes së*

*specifikuar në Manual. Në fazën e Raportimit, Raporti Përfundimtar të përmbajë një Opinion të Përgjithshëm mbi auditimin, si dhe terminologjia e përdorur në raport të jetë konform asaj të shprehur në Manual. Për çdo fazë të auditimit të përputhshmërisë, duhet të hartohen formularët standardë të auditimit, pasi nuk janë ende pjesë përbërëse e Manualit.*

*-Në lidhje me auditimet pilot bazuar në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, edhe dokumentet e përfshira në dosje duhet të jenë në përputhje me specifikat e trajtuara në manual. Të rishikohen rubrikat e Fazës së Planifikimit, ku të dokumentohet vlerësimi i materialitetit dhe i riskut.*

*-Të bëhet ndarja e saktë e Projektit të Planifikimit të Auditimit dhe të Programit të Auditimit, duke u hartuar formati standard i tyre. Në fazën e kryerjes së auditimit në terren, të hartohen procedurat standarde sipas mënyrës dhe përmbajtjes së specifikuar në Manual. Në fazën e Raportimit, Raporti Përfundimtar të përmbajë një Opinion të Përgjithshëm mbi auditimin, si dhe terminologjia e përdorur në raport të jetë konform asaj të shprehur në Manual. Për çdo fazë të auditimit të përputhshmërisë, duhet të hartohen formularët standardë të auditimit, pasi nuk janë ende pjesë përbërëse e Manualit.*

*Menjëherë*

*Shënim 1: Qëllimi i shqyrtimit për sigurimin e cilësisë së punës audituese është që drejtuesit e lartë të institucionit të marrin siguri të arsyeshme, që auditimet janë kryer në përputhje me standardet dhe metodat e miratuara dhe në zbatim të detyrimeve kushtetuese e ligjore. Duke vlerësuar performancën e arritur në drejtim të përmirësimit të sigurimit të cilësisë së punës audituese, si dhe duke reflektuar ndaj të metave e mangësive të vërejtura gjatë shqyrtimit të dosjeve të auditimit për kontrollin e sigurimit të cilësisë, në zbatim të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të KLSH, do të behet i mundur arritja e qëllimit të këtij kontrolli.*

*Gjithashtu, zbatimi i këtij procesi shqyrtimi, shtron kërkesa për të identifikuar e pasqyruar objektivisht mangësitë, përmirësimet që duhen bërë dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e punës në të ardhmen, prandaj është detyrë e drejtuesve të departamenteve që konkluzionet e rekomandimet e raportit të sigurimit të cilësisë të mbahen parasysh në vlerësimin vjetor të punës të audituesve.*

*Në përmbushje dhe të ISSAI 40 dhe në kuadër të projektit IPA 2013 “Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm”, me kolegët e SAI Kroat në misionet e zhvilluara në KLSH, jemi duke punuar për të hartuar dokumentin e Politikës së Sistemeve të Kontrollit si dhe hartimin e Udhëzuesve për Sigurimin e Cilësisë (Guide line on Quality Assurance) për çdo lloj auditimi, përputhshmërie, financiar dhe performance.*

*Finalizimi i këtyre dokumenteve, si dhe zbatimi i Formularëve Standardë të Auditimit pritet të miratohet nga Kryetari i KLSH në zbatim të Rregullores së re, do të krijojë një sistem më të përshtatshëm të kontrollit të cilësisë i cili do të çojë në minimizimin e risqeve për cilësinë.*

*Shënim 2: Ky material do të punohet nga grupi për shqyrtimin e cilësisë në analizën vjetore të departamenteve të auditimit, që do të zhvillohen brenda dy javëve të para të*

muajit janarit 2017. Rekomandimet e këtij materiali do reflektohen (nga Sekretari i Përgjithshëm) edhe ne rregulloren e re te procedurave të auditimit, që hyn në fuqi me date 1 janar 2017.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**